



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E AGJECIVE FUNERALE / SHTËPI FUNERALE (SALLA PRITJE), NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR”.

Konsultim publik : I Hapur

Data : 28.01.2025

Ora : 13:30

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 16, nga të cilët 3 gra,.*

Titulli i projekt-aktit që konsultohet : “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për licensimin e agjencie funerale/shtëpi funerale (salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër”.

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Znj.Leqejza** , drejtoreshë juridike në Bashkinë Shkodër. Ajo bën një prezantim të detajuar të projekt vendimit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër.

Në vijim fjala i jepet të pranishëmve.

Z.Illir Mani shprehet se ka mbi 25 vite që ushtron aktivitetin e tij me agjensi funerale. Ne jemi të vetëdijshëm që nuk mund të dalim kundër ligjeve të shtetit, por minimalisht kërkojmë nga Bashkia Shkodër të merret në konsideratë harta që vetë ajo ka afishuar. Ai shton se kanë marr një njoftim Nga Bashkia me datë 29.02.2024 për marrje masash për mbylljen e sallave të pritjes. Por në vend

që të mbyllen, sallat e pritjes vetëm janë shtuar. **Z.Mani** kërkon që të respektohet konkurenca e ndershme dhe të lihet të punojnë të paktën zyrat funerale, që të shërbejnë si pika kontakti me klientin. Gjithashtu ai shprehet se ato nuk mund të sigurojnë ambiente të posaçme për të kryer procedurat e kërkuara me kufomën në rregullore, pasi ato lejohen vetëm në morg.

Fjalën e merr **Z.Mirsad Skenderaj**, subjekti “Elita”, i cili shprehet se ka depozitur edhe një e-mail për të dhënë sugjerimet e tij në lidhje me pr/rregulloren. Si subjekt i kesaj teme ai dëshiron të bëjë disa sugjerime për disa ndryshime.

Pikë së pari, mendon se tek dispozita e përgjithshme e rregullores duhet të bëhet ndarja e agjensive funerale me sallat e pritjes. Ai shton se Agjensitë funerale (zyrat) në çdo qytet të Europës, janë në godina shumëfamiljare banimi dhe nuk kanë kufizim për sa i përket kësaj pjese.

Ndërsa për sa i përket kushteve dhe kriterëve të licensimit të Agjensive të shërbimit funeral tek pika 2 do kishte sugjeruar, që agjensia duhet të disponoj 2 ambiente; 1 zyrë dhe 1 ekspozitor për produktet që ofrojnë. Ekspozita mund të jetë në një ambient prapa dhe e padukshme nga jashtë sepse produktet tona janë të ndryshme në cilësi dhe çmim dhe klientët kanë nevojë t'i shohin.

Po ashtu edhe tek pika 7 e rregullores do kisha sugjeruar ndryshime, pasi unë personalisht kam një godinë që nuk shërben për banim, por në certifikatën e pronësisë rezulton si e tillë, aq më tepër që hyrjen e biznesit e kemi në anën tjetër të banesës.

Gjithashtu edhe tek pika 8. thuhet se kusht i domosdoshëm është që të ketë të paktën dy punonjës të siguruar. Edhe kjo bie poshtë sepse disa i kanë biznese të vogla, nuk janë me TVSH sepse ka agjensi funerale që bëjnë dy raste në muaj dhe nuk mund të krahasohet me një që bën 30 raste në muaj.

Përgjigjet për këtë **Znj.Shllaku**, drejtoreshë në Drejtorinë e Mjedisit, Bashkia Shkodër e cila shprehet se këtë nuk e vendosim ne, kjo është e përcaktuar saktë me VKM, që nuk lejohen të tilla subjekte në godina banimi, as në shtesa dhe as për zyra apo për salla.

Tjetër sugjerim nga **Z.Skenderaj** është edhe nevoja që kanë këto subjekte për të patur edhe një ekspozitë me objektet që ato “tregtojnë”. Ato mund të krijojnë edhe hapësira të dedikuara, të padukshme nga jashtë.

Sqaron edhe njëherë **Znj.Shllaku** duke thënë se pikërisht për këtë kërkohet që ekspozitori të jetë i padukshëm nga jashtë.

Z.Gjergj Sokoli, anëtar i Këshillit Bashkiak, shprehet se është dakort që duhet ndarë salla e pritjes nga zyrat e agjensisë funerale. E rëndësishme është që mos të ketë reklamime të produkteve. Ai shton se nuk duhet që subjektet të penalizohen për këtë.

Znj.Brikena Leqejza sqaron se në draft/rregulloren ka kriterë të ndryshme për licensimin e zyrave me ato për sallat e pritjes. Ajo thekson faktin që është e ndaluar që subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në godina banimi.

Fjalën e merr **Z.Armir Bektashi**, subjekti “Bektashi”, i cili thotë se shërbimi që ne ofrojmë i shton më shumë kostot qyterarëve në këtë mënyrë që parashikohet në këtë rregullore, pasi nëse nuk na lejohet të kemi ambientet (salla pritje, zyra) brenda qytetit, kjo do përkthehet deri diku në vështërsi të aksesit dhe pse jo për shumë e pamundur. Ai shton se po pretendohet nga ju që ka patur ankesa nga qytetarët, por nuk mund ta besoj pasi të gjithë qytetarët e Shkodrës i kryejnë këto

shërbime tek ne, dhe vetëm urime kemi marr nga ato. Për më tepër është e pamundur që produktet dhe shërbimet tona të mos shihen nga jashtë. Minimalisht kërkojmë që të lejohen zyrat e kontaktit dhe të zbatohet harta që është afishuar nga Bashkia për sallat e pritjes. Gjithashtu ai shprehet se me kriteret e kësaj rregulloreje po tregoheni shumë të rreptë, sepse po penalizohemi. Nuk duhet harruar asnjëherë që Shkodra i ndjek dhe i respekton traditat dhe zakonet. Ne jemi shërbim i domosdoshëm për popullatën.

Z.Mani merr fjalën përsëri dhe pyet nëse Bashkia Shkodër do e kishte të mundur hapjen e një zyre funerale që të ofrohet shërbim i saktë dhe të ketë konkurrencë të ndershme.

Përsëri **Z.Bekteshi** thotë se për sa i përket vendit të larjes, ai nuk mendon se përbën problem për banorët e godinës ku është salla, pasi nuk ka pse të jetë detyrimisht morg. Ka edhe familjarë që nuk pranojnë ta çojnë në morg kufomën. Ai pyet si mendohet të procedohen në rastet kur familjarët duan ta kryejnë varrimin në shtëpi. A do ketë pengesa edhe për ato, pasi mund të ketë ankesa edhe për to.

Z.Boriçi, administrator i subjektit “Boriçi” shprehet se ai mendon që kriteret për sallat e pritjes duhet të rishihen dhe të rivlerësohen nëse plotësohen kushtet e kërkuara apo apo jo. Gjithashtu ai thotë se në lidhje me ankesat, beson se janë të pasakta dhe vijnë nga konkurrenca. Ai shton se nuk duhet të harrojmë se Shkodra është qytet që i ruan traditat e zakonet.

Pyetje dhe diskutime të tjera nga të pranishmit nuk ka . Dëgjesa për “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për licensimin e agjencive funerale / shtëpi funerale (salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër”.deklarohet e mbyllur.

SEKRETARE

Sabina Danaj



Mbajtësi i procesverbalit:

Irma Sulishti

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Irma", is written below the printed name.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË

DËGJESË PUBLIKE: "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E AGJENCIVE FUNERALE/SHTËPI FUNERALE (SALLA PRITJE), NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR".

Date: 28.01.2025

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Armit Borigi	Perrucë	0692039411		<i>[Signature]</i>
2.	ADILIR HOTI	SALLA HOTI	0692099021		<i>[Signature]</i>
3.	Alma Koca	Veriçofë	0694641543		<i>[Signature]</i>
4.	EDMOND KOCALI	Veriçofë	0694641543		<i>[Signature]</i>
5.	<i>[Signature]</i>				<i>[Signature]</i>
6.	<i>[Signature]</i>				<i>[Signature]</i>
7.	<i>[Signature]</i>	Perrucë	0692024773		<i>[Signature]</i>
8.	<i>[Signature]</i>				<i>[Signature]</i>
9.	Armen Orlaci	Perrucë	0694824475		<i>[Signature]</i>
10.	Florida Orlaci	Anësorë KB			<i>[Signature]</i>
11.	Alma Bëkteshi	30 DEKTESHI	0697044690		<i>[Signature]</i>
12.	Mirsad Skenderaj	Rus	0695532325		<i>[Signature]</i>
13.	Alma Mëdhi	Flitë V. D. F.	0693391658		<i>[Signature]</i>
14.	Jonus Shymaj	Pr Shima	0677342964		<i>[Signature]</i>
15.	Agim Sokoli	K. Sh. Bashk.	0682080805		<i>[Signature]</i>
16.	<i>[Signature]</i>	KB. Shkoder			<i>[Signature]</i>

[Handwritten signature]